



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Nr. 339/Prot.

Tiranë, më 31.03.2020

URDHËR

Nr. 48, datë 31.03.2020

PËR
MONITORIMIN NË MEDIA TË DENONCIMEVE TË RASTEVE ABUZIVE ME
FONDET DHE PASURINË PUBLIKE

Bazuar në ligjin nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 25; “Rregulloren e brendshme mbi funksionimin organizativ të Kontrollit të Lartë të Shtetit” të ndryshuar, neni 10, pika 10.3, si dhe në situatën e krijuar nga zbatimi i Aktit normativ nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar, me qëllim të rritjes së forcës zbuluese dhe parandaluese të veprimtarisë audituese të rasteve abuzive me fondet dhe pasurinë publike,

URDHËROJ:

1. Ngrihet grupi i punës për monitorimin e rasteve të denoncuar në media mbi abuzimet me fondet dhe pronën publike gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, me këtë përbërje:
 1. Gjovalin Preçi,
 2. Amantia Patosi,
 3. Bashkim Harizaj,
 4. Kozma Kondakçiu,
 5. Delor Prosi.
2. Grupi i punës do të monitorojë të gjitha mediat e shkruara online dhe vizive, portalet si dhe rrjetet sociale për rastet e denoncuar të abuzimeve me fondet dhe pronën publike, duke evidentuar datën, burimin, çështjen e ngritur dhe shënime të tjera në se vlerësohet e nevojshme.
3. Grupi i punës, gjatë kësaj periudhe, përgatit çdo 10 ditë një përmbledhëse të rasteve të rezultuara nga ky monitorim dhe ja paraqet Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Drejtorëve të Përgjithshëm dhe çdo Drejtori të Departamenteve. Drejtorët e Departamenteve do t'i kenë në vëmendje në hartimin e programeve të auditimit në proces.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

